- teknik për transport dhe shpediton	maq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 60 pikë
-drejtues me makina për bartjen e materialeve	maq.	25 nx.	1 par.	kzgj. 3 v.	minimum 30 pikë
*(bashkëpunim me kompanitë DGT "ZHIKOL" Strumicë)					

Drejtimi pylltari dhe përpunim i drurit - 25 nxënës, 1 paralele

- teknik për mobilje dhe enterier	maq	25 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 45 pikë
*(bashkëpunim me SHPTSH ARTISAN MEBEL" Strumicë , SHPK Nipoprom,SHPTSH Eko Dizajn, SHPKNJP " Savello Dragolub)					

Drejtimi ndërtimtari dhe gjeodezi -59 nxënës, 2 paralele

- teknik i ndërtimtarisë	maq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 45 pikë
- tesar, përforsim dhe betonizim	maq	25 nx.	1 par.	kzgj.3 vj	minimum 30 pikë

*(bashkëpunim me kompanitë
DGT "ZHIKOL" Strumicëe

TETOVË

96.SHKOLLA E MESME KOMUNALE GJIMNAZI „KIRIL PEJÇINOVIQ”

Në vitin e parë do të regjistrohen 510 nxënës në 15 paralele (102 nxënës në 3 paralele me mësim në gjuhën maqedonase dhe 408 nxënës në 12 paralele me mësim në gjuhën shqipe) sipas planeve dhe programeve mësimore për:

Gjimnaz - 510 nxënës, 15 paralele, minimum 60 pikë

maq 102 nx. 3par.

shq 374nx. 11 par.

Gjimnaz – 34 nxënës, 1 paralele, minimum 60 pikë

(paralele bilinguale – gj.shqipe – gj. frenge)

97.SHKOLLA E MESME KOMUNALE GJIMNAZI I DYTË „7 MARS”

Në vitin e parë do të regjistrohen 272 nxënës në 8 paralele me mësim në gjuhën shqipe sipas planeve dhe programeve mësimore për:

Gjimnaz - 272 nxënës, 8 paralele, minimum 60 pikë

shq 272 nx. 8 par.

98.SHKOLLA E MESME KOMUNALE E MEDICINËS „NIKOLLA SHTEJN”

Në vitin e parë do të regjistrohen 660 nxënës në 21 paralele (195 nxënës në 6 paralele me mësim në gjuhën maqedonase, 431 nxënës në 14 paralele me mësim në gjuhën shqipe dhe 34 nxënës në 1 paralele në gjuhën turke) sipas planeve dhe programeve mësimore për:

Drejtimi shëndetësi - 626 nxënës, 19 paralele

- motër medicinale *(në bashkëpunim me ISHP Bamikor, ISHP Dr. Svetlana, ISHP FI-OL, ISHP Medicinë Tetovë, ISHP Medika Centar)	maq	25 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 70 pikë
- motër medicinale	shq	136 nx.	6 par.	kzgj. 4v	minimum 70 pikë
- motër medicinale *(në bashkëpunim me ISHP Medikus Lux, ISHP Preventiva, ISHP Dr. Mirdita, ISHP Dr. Gazmend, ISHP AR-Medika, ISHPA Anakonda, ISHP Medika-Lux, ISHP Dr. Engin, ISHP Omega Medika, ISHP D-r. Bekim, ISHP Medica)	shq	50 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 70 pikë
- motër medicinale	tur	34 nx.	1 par.	Kzgj.4 v.	minimum 70 pikë
- teknik i dhëmbëve	maq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 70 pikë
- teknik i dhëmbëve	shq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 70 pikë

*(në bashkëpunim me ISHP Dredent, ISHP Pro dent, ISHP Roni Dent, ISHP Sara Dent, ISHP Vita Dent)

- laborator medicinal-teknik sanitar	shq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 70 pikë
- asistent dental	shq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 70 pikë
- teknik i farmacisë	maq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 70 pikë
- teknik i farmacisë	shq	50 nx.	2 par.	kzgj. 4v	minimum 70 pikë

*(në bashkëpunim me ISHP Kemofarmacia, ISHP Vela-Farm, ISHP Barnatorja Anakonda 4, ISHP Kemofarmacia EM1, ISHP Barnatorja AnaKonda, ISHP Maltom-Farm, ISHP Atoris Farm, ISHP Atoris Farm , ISHP Atoris Farm 1, ISHP Atoris Farm 2 ISHP Vela Farm 1,

- teknik i fizioterapisë	maq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 70 pikë
-teknik i fizioterapisë	shq	68nx.	2 par.	kzgj.4 v	minimum 70 pikë
-teknik medicinal laboratorik-sanitar	maq	34 nx	1 par	kzgj.3 v	minimum 30 pikë

Shërbime personale - 68 nxënës, 2 paralele

- teknik i përkujdesjes kozmetikë dhe bukurisë	shq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 45 pikë
- teknik i përkujdesjes kozmetike dhe bukurisë	maq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 45 pikë

99. SHKOLLA E MESME EKONOMIKE KOMUNALE “8 SHTATORI”

Në vitin e parë do të regjistrohen 325 nxënës në 13 paralele (84 nxënës 3 paralele me mësim në gjuhën maqedonase dhe 250 nxënës në 10 paralele me mësim në gjuhën shqipe) sipas planeve dhe programeve mësimore për:

Drejtim ekonomi-juridik dhe tregëti – 325 nxënës, 13 paralele

- teknik i ekonomisë	maq	50 nx.	2 par.	kzgj. 4v	minimum 60 pikë
----------------------	-----	--------	--------	----------	-----------------

*(bashkëpunim me TD Mitrusheski Konsalting, Biro Maria Kont, Shoqata për auditim Bend,)

- teknik i ekonomisë	shq	200 nx.	8 par.	kzgj. 4v	minimum 60 pikë
----------------------	-----	---------	--------	----------	-----------------

*(bashkëpunim me Auto CEM, Arva Kont 93, Dinor Konsalting, Euro Fati, Golec Kompania , Lindi Konsalting, Arbëria Konsalting, Euro Gips Fih, Balkan Triticum Mel,)

- teknik juridiku	maq	25 nx.	1 par..	kzgj. 4v	minimum 60 pikë
-------------------	-----	--------	---------	----------	-----------------

*(bashkëpunim me Noter Vaska Blazhevska, Përmbarruesin Cvetanka Trenevska, avokat Nikolla Apostolovski, jAvokati Kristina Dimçeska)

- teknik juridiku	shq	50 nx.	2 par..	kzgj. 4v	minimum 60 pikë
-------------------	-----	--------	---------	----------	-----------------

*(bashkëpunim me Avokat Vullnet Zenki, Avokat Ibrahim Bajrami, Avokat Valon Abdulhamidi)

100. SHKOLLA E MESME KOMUNALE E TEKSTILIT „GJOCE STOJÇESKI”

Në vitin e parë do të regjistrohen 259 nxënës në 10 paralele (25 nxënës në 1 paralele me mësim në gjuhën maqedonase dhe 234 nxënës në 9 paralele me mësim në gjuhën shqipe) sipas planeve dhe programeve mësimore për:

Drejtimi tekstil dhe lëkurë – 125 nxënës, 5 paralele

- teknik për përpunimin e veshjes	maq	25 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 45 pikë
*(bashkëpunim me Marelli Grup, Mission SHPKNJ, Imperial HTT, DI-SIMONE Tetovë)					
- teknik për përpunimin e veshjes	shq	50 nx.	2 par.	kzgj. 4v	minimum 45 pikë
*(bashkëpunim me Marelli Grup, Mission SHPKNJ , Imperial HTT, DI-SIMONE Tetovë)					
- teknik për dizajnin e veshjes	shq	25 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 45 pikë
*(bashkëpunim me Marelli Grup, Mission SHPKNJ , Imperial HTT, DI-SIMONE Tetovë)					
-teknik për modelimin e veshjes	shq	25 nx.	1 par.	kzgj.4 v.	minimum 45 pikë
*(bashkëpunim me Marelli Grup, Mission SHPKNJ , Imperial HTT, DI-SIMONE Tetovë)					

Drejtimi kimi-teknologji - 100 nxënës, 4 paralele

- teknik i laboratorit kimik	shq	50 nx.	2 par.	kzgj. 4v	minimum 45 pikë
*(bashkëpunim me kompanitë GREEN PRODUKT, ZHITO POLLOG,Hit 73 Grubacioni DDA)					
- teknik i ushqimit	shq	25 nx	1 par.	kzgj.4 v.	minimum 45pikë
*(bashkëpunim me kompanitë GREEN PRODUKT, ZHITO POLLOG,Hit 73 Grubacioni DDA)					
-teknik për mbrojtjen e mjedisit	shq	25 nx	1par.	kzgj. 4v.	minimum 45.pikë
*(bashkëpunim me kompanitë GREEN PRODUKT, ZHITO POLLOG,Hit 73 Grubacioni DDA)					

Arsimi i artit – 34 nxënës, 1 paralele

- teknik për dizajn interieri, mobilje dhe prodhime industriale	shq	34 nx	1 par	kzgj. 4v	minimum 45 pikë
---	-----	-------	-------	----------	-----------------

101. SHKOLLA E MESME SHTETËRORE – QENDRA RAJONALE PËR ARSIM DHE TRAJNIM PROFESIONAL „MOSHA PIJADE”

Në vitin e parë të shkollës do të regjistrohen 932 nxënës 29 paralele (433 nxënës në 13 paralele me mësim në gjuhën maqedonase dhe 499 nxënës në 16 paralele me mësim në gjuhën shqipe) sipas planeve dhe programeve mësimore përkëto drejtime:

Drejtimi komunikacion - 170 nxënës, 5 paralele

- teknik për komunikacion rrugor	maq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 55 pikë
- teknik për komunikacion rrugor	shq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 55 pikë
- teknik për transport dhe shpedicion	maq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 60 pikë
- teknik për transport dhe shpedicion	shq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 60 pikë
- drejtues i makinave për bartjen e materialeve	shq	34 nx.	1 par.	kzgj.3 v.	minimum 30 pikë

Drejtimi makineri – 313 nxënës, 10 paralele

- teknik i makinerisë/ teknik për menaxhim me kompjuter	shq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 45 pikë
-teknik për makineri prodhuese *(bashkëpunim me KIEL MAQEDONI SHPKNJP Tetovë)	maq	25nx.	1par.	kzgj. 4v	Minimum 55 pikë
- teknik për prodhimin e makinerisë *(bashkëpunim me KIEL MAQEDONI SHPKNJP Tetovë)	shq	25 nx	1 par	kzgj. 4v	minimum 55 pikë
- teknik i makinerisë për automjete motorike	maq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 45 pikë
- teknik i makinerisë për automjete motorike	shq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 45 pikë
-teknik për menaxhimin kompjuterik/ Teknik i makinerisë energjetike	maq	34nx.	1par.	kzgj.4 v.	minimum 45 pikë
- automekanik	maq	34 nx	1 par	kzgj.4 v	minimum 45 pikë
-automekanik	shq	34 nx.	1 par.	kzgj.3 v.	minimum 30 pikë
- instalues i ngrohjes dhe kondicionerit	maq	34nx.	1 par.	kzgj. 3 v.	minimum 30 pikë
-instalues i ngrohjes dhe kondicionerit *(bashkëpunim me DPUP B.F.M Kompani SHPKNJP	shq	25 nx.	1 par.	kzgj. 3 v.	minimum 30 pikë

Drejtimi bujqësi dhe veterinar – 127 nxënës, 4 paralele

- teknik i veterinarisë medicinale	maq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 45 pikë
- teknik i veterinarisë medicinale *(bashkëpunim me kompaninë VEZE SHARI SHPK)	shq	25 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 45 pikë
- teknik i agronomisë/ teknik i agronomisë për prodhim tradicional dhe organik	maq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 40 pikë
- teknik i agronomisë/ teknik i agronomisë për prodhim tradicional dhe organik	shq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 40 pikë

Drejtimi hotelieri dhe turizëm - 127 nxënës, 4 paralele

- teknik i hotelierisë dhe turizmit	maq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 45 pikë
- teknik i hotelierisë dhe turizmit - kuzhinjer /kamerier	shq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 45 pikë
- kuzhinjer /kamerier	maq	34 nx.	1 par.	kzgj. 3v.	minimum 30 pikë
- kuzhinjer / kamerier *(bashkëpunim me kompaninë TP NP BOSS)	shq	25 nx.	1 par.	kzgj. 3v.	minimum 30 pikë

Drejtimi elektroteknikë –161 nxënës, 5paralele

- elektroteknik për teknikë kompjuterike dhe automatikë	maq	34 nx.	2 par.	kzgj. 4v	minimum 55 pikë
- elektroteknik për teknikë kompjuterike dhe automatikë	shq	34nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 55 pikë
-elektroteknik-teknik i energjetikës - elektroteknik i energjetikës *(bashkëpunim me kompaninë VEZE SHARI SHPK)	maq	34.nx.	1par.	kzgj.4.v.	minimum 45 pikë

- elektrikistë shq 34 nx. 1 par. kzgj. 3v. minimum 30 pikë

Drejtimi ndërtimtari dhe gjeodezi - 34 nxënës, 1 paralele

- teknik i ndërtimtarisë shq 34 nx. 1 par. kzgj. 4v minimum 45 pikë

102. SHKOLLA SHTETËRORE E MUZIKËS „TODOR SKALOVSKI – TETOEC”

Në vitin e parë do të regjistrohen 68 nxënës në 2 paralele (34 nxënës në 1 paralele me mësim në gjuhën maqedonase dhe 34 nxënës në 1 paralele në gjuhën shqipe) sipas planeve dhe programeve mësimore përkëto drejtime:

Arsimi i artit – art muzikor - 68 nxënës, 2 paralele

- muzicent i teorisë dhe muzicent performues	maq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 60 pikë
- muzicent i teorisë dhe muzicent performues	shq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 60 pikë

QENDRA E ZHUPËS

103.SHKOLLA E MESME KOMUNALE „ATA”

Në vitin e parë do të regjistrohen 68 nxënës në 2 paralele (34 nxënës në 1 paralele me mësim në gjuhën maqedonase dhe 34 nxënës në 1 paralele me mësim në gjuhën turke) sipas planeve dhe programeve mësimore për :

Gjimnaz- 68 nxënës, 2 paralele, minimum 60 pikë

maq.	34 nx.	1 par
tur.	34 nx.	1 par

SHTIP

104.SHKOLLA E MESME KOMUNALE GJIMNAZI „SLLAVÇO STOJMENSKI”

Në vitin e parë do të regjistrohen 238 nxënës në 7 paralele me mësim në gjuhën maqedonase sipas planeve dhe programeve mësimore për:

Gjimnaz - 238 nxënës, 7 paralele, minimum 60 pikë

105.SHKOLLA E MESME KOMUNALE „KOLE NEHTENIN”

Në vitin e parë do të regjistrohen 254 nxënës në 8 paralele me mësim në gjuhën maqedonase sipas planeve dhe programeve mësimore për:

Drejtimin makineri – 93 nxënës, 3 paralele

- teknik për menaxhim kompjuterik / teknik i makinerisë *(në bashkëpunim me AKTiva SHPK)	maq	25 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 45 pikë
- teknik i makinerisë për automjete- motorike /teknikë i makinerisë dhe energjetikës	maq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 45 pikë
- mekanik i makinerisë/mekanik i konstruksioneve	maq	34 nx.	1 par.	kzgj. 3v.	minimum 30 pikë

Drejtimi elektroteknikë – 127 nxënës, 4 paralele

- elektroteknik -energjetikë *(në bashkëpunim me Elektrodistribucia SHPKJNP, Llon SHPK – Sveti Nikoll;, Jole SHPKNJNP , T&M SHPKNJNP , NP Hidro system Zletovicë)	maq	25 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 45 pikë
- elektroteknik për elektronikë dhe telekomunikacion	maq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 50 pikë
- elektroteknik për teknikë kompjuterike dhe automatikë	maq	68 nx.	2 par.	kzgj. 4v	minimum 55 pikë

Drejtimi hotelieri dhe turizëm - 34 nxënës, 1 paralele

- kamerier/kuzhinjer	maq	34 nx.	1 par.	pr. 3 v.	minimum 30 pikë
----------------------	-----	--------	--------	----------	-----------------

106. SHKOLLA E MESME KOMUNALE „DIMITAR MIRASÇIEV”

Në vitin e parë do të regjistrohen 93 nxënës në 3 paralele me mësim në gjuhën maqedonase sipas planeve dhe programeve mësimore për:

Drejtimi tekstil dhe lëkurë - 93 nxënës, 3 paralele

- teknik për përpunimin e veshjes *(bashkëpunim me, LABOD MAK SHPK, Astibo Feshën Grup, Astibo Bejzik SHPKNJNP,	maq	25 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 45 pikë
-teknik i modelimit të veshjes/teknik për dizajnin e veshjes	maq	34 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 45 pikë
- konfeksioner	maq	34 nx.	1 par.	kzgj.3 v.	minimum 30pikë

107.SHKOLLA E MESME KOMUNALE „JANE SANDANSKI”

Në vitin e parë do të regjistrohen 175 nxënës në 7 paralele sipas planeve dhe programeve mësimore për:

Drejtimi shëndetësi – 175 nxënës, 7 paralele

- motër medicinale *(në bashkëpunim me ISHP Spitali Klinik, ISHP “Prim. Dr. Samarxhiski”, ISHP SHtëpia e Shëndetit "Pançe Karagjozov)	maq	75 nx.	3 par.	kzgj. 4v	minimum 70 pikë
--	-----	--------	--------	----------	-----------------

- teknik i dhëmbëve *(në bashkëpunim me ISHP "Den Estet" - Shtip, ISHP Solis Dent, ISHP laborator dentar "Apolonia 09" – Koçan, ISHP laborator dentar "Gordana"- Koçani, ishp laborator dentar proestetikë – Probishtip, ISHP laborator dentar "Tekno dent – Koçan, ISHP Super Dent protetikë Dr. Vllado Jordanov, ISHP" – Shtip Prim.Dr. Dr. Bllagoj Nikov", ISHP "Denticia")	maq	25 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 70 pikë
- teknik i farmacisë *(në bashkëpunim me ISHP Spitali Klinik, ISHP Radolek, ISHP Higjja EZIMIT SH.PKNJP Shtip)	maq	25 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 70 pikë
- teknik i fizioterapisë	maq	25 nx.	1 par.	kzgj. 4v	minimum 70 pikë
- motër medicinale për gjinekologji dhe akushi *(bashkëpunim me ISHP Spitali klinik, ISHP "Dr. Violeta Eftimova"	maq	25 nx	1 par	kzgj.4v	minimum70 pikë

108. QENDRA SHKOLLORE SHTETËRORE E MUZIKËS „SERGEJ MIHAJLOV”

Në vitin e parë do të regjistrohen 68 nxënës në 2 paralele me mësim në gjuhën maqedonase sipas planeve dhe programeve mësimore për:

Arsimi i artit – art muzikor –68 nxënës, 2 paralele

- teoriticient i muzikës	maq	34 nx.	1 par	kzgj. 4v	minimum 60 pikë
- muzicentë performues	maq	34 nx.	1 par	kzgj. 4v	minimum 60 pikë

109. QENDRA PËR ARSIM TË MESËM SPECIAL PROFESIONAL „ISKRA”

Në vitin e parë në arsimin profesional dyvjeçar me kohëzgjatje prej tre viteve sipas planeve dhe programeve mësimore të adaptuara, mund të regjistrohen nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (me aftësi të kufizuara intelektuale të zhvillimit psikofizik), në profesionet dhe drejtimet e mëposhtme:

Drejtimi bujqësi dhe veterinari

- ndihmës në prodhimin bimor

Drejtimi makineri

- ndihmës bravandreqës-limar

Drejtimi tekstil dhe lëkurë

- ndihmës konfeksioner

Drejtimi grafikë

- ndihmës -lidhës librash-kartonazher

Gjithashtu, në vitin e parë për **aftësim për punë** me kohëzgjatje deri në dy vite sipas planeve dhe programeve mësimore të adaptuara, mund të regjistrohen nxënësit të cilët nuk mund t'i ndjekin planet dhe programet mësimore profesionale tre vjeçare të lartpërmendura, në drejtimet e mëposhtme:

Drejtimi grafikë

I. PARALELET NË PËRBËRJE TË SHKOLLAVE TË MESME PUBLIKE TË CILAT JANË TË SHPËRNDARA

Paralele në përbërje të shkollave të mesme publike ka në:

- Shkolla e mesme komunale „Aco Ruskovski” – Berovë në Pehçevë,
- Shkolla e mesme komunale „28 Nëntori” – Dibër në Mogorçë,
- Shkolla shtetërore e muzikës „Todor Skalovski- Tetoec” – Tetovë në Strugë,
- Shkolla e mesme e Qytetit të Shkupit „Vllado Tasevski ” në Shkollën e mesme të Qytetit të Shkupit „8 Shtatori”,
- Shkolla e mesme shtetërore për rehabilitim dhe arsim „Shën Naumi i Ohrit” Shkup në Shkollën e mesme „Taki Daskallov” – Manastir dhe

Paralele në përbërje të shkollës së mesme shtetërore Akademia e Sportit ka në:

- SHMK „Kuzman Shapkarev” – Manastir, futboll, henboll;
- SHMK „Pero Nakov” - Kumanovë, basketboll;
- SHMK “Gjorçe Petrov” Kavadar basketboll;
- SHMSHQ RAPT „Vanço Pitosheski” – Ohër, futboll ;
- SHMK Gjimnazi „Mirçe Acev” – Prilep, futboll;
- SHMK Nikolla Karev - Strumicë , futboll
- SHMK Kiril Pejçinoviç” – Tetovë, futball,
- SHMK „Koço Racin” – Veles, futball,
- SHMK „Gostivar” – Gostivar, futball dhe
- SHMK „Kole Nehtenin” – Shtip, futboll.

II. KUSHTET E REGJISTRIMIT DHE KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E NXËNËSVE

Regjistrimi i nxënësve në shkollat e mesme publike (në tekstin e mëtejme: shkollat) për vitin shkollor 20223/2024 do të realizohet në kushte dhe në mënyrë të përcaktuar me Ligjin për Arsimin e Mesëm, Ligjin për Arsimin Profesional dhe Trajnim, Ligjin për Akademinë e Sportit, Ligjin për Gjimnazin Matematikë – Informatikë dhe me këtë konkurs.

Kushtet për regjistrimin e nxënësve në vitin e parë janë:

- të kenë përfunduar arsimin fillor
- të mos jenë mbi moshën 17 vjeçare;
- të përcaktohen për njërin nga planet dhe programet e mëposhtme:

a) gjimnaz ;

b) arsim profesional dhe trajnim;

c) arsimit i mesëm i artit

ç) arsim i mesëm për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore;
të plotësohen kriteret e përcaktuara në këtë konkurs

Kriteret për përzgjedhjen e nxënësve janë:

- suksesi mesatar i nxënësit nga klasa e VI deri në të IX;
- suksesi mesatar i nxënësit të arritur në këto lëndë (gjuhë amtare, gjuhë e huaj dhe dy lëndë të rëndësishme për profesionin);
 - diploma për vendet e fituara (I, II dhe III) nga garat ndërkombëtare, si dhe garat shtetërore (të organizuara nga shoqata të akredituara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës) në gjuhën amtare, gjuhë të huaj, shkencat natyrore, matematikë, kimi, fizikë, biologji dhe gjeografi dhe lëndët mësimore që janë të rëndësishme për profesionin përkatësisht fushën zgjedhore;
- vlera mesatare e pikëve të fituara për sjelljen nga klasa VI deri në klasën IX.

Për nxënësit të cilët konkurojnë për regjistrim në Akademinë e Sporteve, përveç kriterëve të lartëshënuara për përzgjedhje, vlerësohen edhe aftësitë sportive në përputhje me Ligjin për Akademinë e Sporteve.

Për nxënësit të cilët konkurojnë për regjistrim në Gjimnazin Matematikë-Informatikë, përveç kriterëve të lartëshënuara të përzgjedhjes, vlerësohen edhe pikët e fituara nga provimi pranues në Matematikë dhe Fizikë në përputhje me Ligjin për Gjimnazin Matematikë-Informatikë.

Në arsimin e mesëm për art mund të regjistrohen edhe nxënësit e talentuar të cilët nuk e kanë përfunduar arsimin fillor mirëpo pas pëlqimit paraprak me shkrim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në bazë të propozimit nga shkolla, me obligim që paralelisht të përfundojë arsimin fillor.

Arsimi i mesëm për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore përfshin nxënësit sipas llojit dhe shkallës së aftësisë së vështirësisë.

Nxënësit nga komuniteti etnik rom mund të regjistrohen në një shkollë të mesme publike të caktuar nëse kanë deri në 10% më pak pikë sesa numri i pikëve të parapara në Konkurs për planet dhe programet mësimore përkatëse dhe nëse plotësojnë kriteret shtesë për testin e njohurive dhe aftësive në shkollën përkatëse.

Transport falas ose akomodim të nxënësve të cilët do të regjistrohen në vitin e parë në shkollat e mesme publike, nuk do të sigurohet nëse lloji i zgjedhur arsimor (profesioni ose drejtimi) ekziston në komunën, përkatësisht rajonin nga vjen.

Në shkollat ku konkurojnë një numër i madh i nxënësve që i plotësojnë kushtet e parapara në këtë konkurs, organizohet një test kualifikues nga materiali mësimor nga klasa e tetë - nëntë në lëndët vijuese:

- gjimnaz – gjuhë amtare dhe matematikë;
- shëndetësi - biologji dhe kimi,
- drejtime tjera - gjuhë amtare dhe matematikë.

Në arsimin e mesëm për art (muzikë, balet dhe art), në gjimnazin për sport, shkollat përcaktojnë kritere shtesë.

Për suksesin mesatar nga klasa VI deri në klasën IX nxënësi mund të marrë më së shumti 50 pikë (suksesi i përgjithshëm nga klasa e gjashtë, shtatë, tetë dhe nëntë, mbledhet, pastaj pjesëtohet me katër dhe i njëjti numër shumëzohet me koeficientin 10).

Për suksesin mesatar të arritur nga katër lëndët e propozuara (dy lëndë mësimore të detyrueshme për të gjitha llojet e arsimit dhe dy lëndë të rëndësishme për profesionin), nxënësi mund të marrë më së shumti 20 pikë (5 pikë për secilën lëndë).

Për vendin e fituar në Gara ndërkombëtare dhe shtetërore nxënësi mund të fitojë:

- Për vendin e parë të fituar ose medaljen e artë në gara ndërkombëtare 5 pikë, vendi i dytë ose medalja e argjentë 4 pikë dhe vendi i tretë ose medalja e bronzë 3 pikë.
- Për vend të fituar në garat shtetërore të akredituara: për vendin e I -rë 3 pikë, për vendin e II-të 2 pikë dhe për vendin e III-të 1 pikë.

Për vlerën mesatare të pikëve për sjelljen nga klasa VI deri në klasën IX, nxënësi mund të marrë më së shumti 5 pikë. (Sjellja shembullore vlerësohet me 5 pikë, sjellja e mirë vlerësohet me 3 pikë dhe sjellja jo e kënaqshme vlerësohet me 0 pikë. Vlera mesatare është shuma e pikëve për sjelljen e klasës së gjashtë, të shtatë, të tetë dhe të nëntë, e ndarë me 4).

Numri i përcaktuar i pikëve minimale për konkurimin e parë është pjesë përbërëse e këtij konkursi.

PASQYRA TABELARE
e lëndëve mësimore nga arsimi fillor të parapara në kriteret për rangimin e
suksesit të nxënësve

NUMRI RENDOR	1. ARSIMI I MESËM PROFESIONAL - DREJTIMI -	LËNDËT MËSIMORE TË OBLIGUESHME	LËNDËT MËSIMORE TË RËNDËSISHME PËR DREJTIMIN
1	gjeologji – xehetari dhe metalurgji	- gjuhë amtare - gjuhë e huaj	- matematikë - fizikë
2	ndërtimtari - gjeodezi	- gjuhë amtare - gjuhë e huaj	- matematikë - fizikë
3	grafikë	- gjuhë amtare - gjuhë e huaj	- kimi - arsim figurativ
4	ekonomi – drejtësi dhe tregëti	-gjuhë amtare -gjuhë e huaj	- matematikë - histori
5	elektroteknikë	- gjuhë amtare - gjuhë e huaj	- matematikë - fizikë
6	shëndetësi	-gjuhë amtare -gjuhë e huaj	- biologji - kimi
7	bujqësi - veterinar	- gjuhë e huaj - gjuhë amtare	- biologji - kimi
8	shërbime personale	- gjuhë amtare - gjuhë e huaj	- biologji - kimi
9	makineri	- gjuhë e huaj - gjuhë amtare	- matematikë - fizikë
10	komunikacion	- gjuhë amtare - gjuhë e huaj	- matematikë - fizikë
11	tekstil-lëkurë	- gjuhë e huaj - gjuhë amtare	- matematikë - kimi
12	hotelieri – turizëm	- gjuhë amtare - gjuhë e huaj	- biologji - gjeografi
13	kimi - teknologji	- gjuhë e huaj - gjuhë amtare	- matematikë - kimi
14	pylltari - përpunim i drurit	- gjuhë amtare - gjuhë e huaj	- matematikë - biologji

NUMRI RENDOR	2. ARSIMI I MESEM- GJIMNAZ - LEMIA / KOMBINIMI -	LËNDËT MËSIMORE TË DETYRUESHME	LËNDËT MËSIMORE TË CILËT JANË TË RËNDËSISHME PËR LËMINË E ARSIMIT
1	fusha natyrore – matematikore (kombinimi A)	- gjuhë amtare - gjuhë e huaj	- matematikë - fizikë
2	fusha natyrore – matematikore (kombinimi B)	- gjuhë amtare - gjuhë e huaj	- matematikë - biologji
3	fusha shoqërore -humane (kombinimi A)	- gjuhë amtare - gjuhë e huaj	- matematikë - histori
4	fusha shoqërore -humane (kombinimi B)	- gjuhë amtare - gjuhë e huaj	- matematikë - histori
5	fusha gjuhësore - arti (kombinim A)	- gjuhë amtare - gjuhë e huaj	- matematikë - histori
6	fusha gjuhësore - arti (kombinim B)	- gjuhë amtare - gjuhë e huaj	- matematikë - histori
Numri rendorë	3.MATEMATIKË – INFORMATIKË lloji i arsimit - GJIMNAZ	LËNDËT MËSIMORE TË DETYRUESHME	LËNDËT MËSIMORE TË CILËT JANË TË RËNDËSISHME PËR LËMINË E ARSIMIT
1	ARSIMI I MESEM GJIMNAZ - LËNDA - MATEMATIKË – INFORMATIKË	- gjuhë amtare - gjuhë e huaj	- matematikë - fizikë
Numri rendorë	4. GJIMNAZI I SPORTIT - lloji i arsimit -	Lëndët mësimore të detyrueshme	Lëndët mësimore të cilët janë të rëndësishme për lëminë e arsimit
1	Arsim Gjimnaz nga Gjimnazi i sportit	- gjuhë amtare - gjuhë e huaj	- biologji - arsim fizik dhe shëndetësor
Numri rendorë	5. ARSIMI I ARTIT - drejtimi -	lëndët arsimore të detyrueshme	Lëndët mësimore të cilët janë të rëndësishme për drejtimin
1	Arti figurativ i aplikuar	- gjuhë amtare - gjuhë e huaj	- arsim figurativ - histori
2	Arsim muzikor	- gjuhë amtare - gjuhë e huaj	- arsimi muzikor - histori
3	Arti i baletit	- gjuhë amtare - gjuhë e huaj	- arsimi muzikor - arsimi fizik dhe shëndetësor

*** Gjuhë amtare: gjuhë maqedonase, gjuhë shqipe, gjuhë turke dhe gjuhë serbe***

III. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR REGJISTRIM

Pas shpalljes së rang litsës, nxënësit të cilët janë në listë dorëzojnë dokumentet në vazhdim:

- fletëparaqitje për regjistrim (fletëparaqitjen për regjistrim e përgatit Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe e publikon në ueb faqen zyrtare);
- dëftesat origjinale nga klasa VI deri në klasën IX;
- diploma (nëse ka) nga vendet e fituara (I, II dhe III) nga garat ndërkombëtare dhe shtetërore në gjuhë amtare, gjuhë të huaj, shkenca natyrore, matematikë, kimi, fizikë, biologji dhe gjeografi si dhe lëndët mësimore që janë të rëndësishme për profesionin, drejtimin, përkatësisht në fushën zgjedhore;
- çertifikata nga libri amë i të lindurve (pavarësisht nga data e lëshimit).

Për regjistrim në Akademinë e Sportit nxënësit dorëzojnë edhe vërtetim për aftësitë, shkathtësitë sportive, për sportet për të cilat nxënësi është i kontrolluar.

Për regjistrim në Shkollën e mesme Matematikë - Informatikë, nxënësit dorëzojnë edhe vërtetim për dhënien e provimit pranues me numrin e pikëve të fituara në matematikë dhe fizikë.

Për regjistrim në programin për maturë ndërkombëtare në shkollën e mesme të Qytetit të Shkupit gjimnazi „Josip Broz Tito” - Shkup, dokumentet e nevojshme dhe të gjitha informatat tjera të nevojshme do të publikohen në tabelën për shpallje të shkollës.

IV. AFATET E KONKURSIT

Konkurimi dhe regjistrimi i nxënësve do të realizohet me një afat të regjistrimit me dy paraqitje në **muajin qershor**. Konkurimi i nxënësve do të bëhet përmes aplikimit elektronik, përmes linkut në portalin për shërbime elektronike të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës <https://e-uslugi.mon.gov.mk> me paraqitje speciale për nxënësit e shkollave të mesme përmes llogarive të tyre të përdoruesve të Schools.mk.

Konkurimi i parë dhe regjistrimi i nxënësve do të bëhet më *20 qershor 2023* deri në ora 24:00, dhe më *21 qershor 2023* deri në ora 15:00. Lista preliminare e renditjes së nxënësve të regjistruar publikohet më *22 qershor 2023* në <https://e-uslugi.mon.gov.mk> dhe në ueb faqen www.mon.gov.mk më së voni deri në ora 09:00.

Dorëzimi i dokumentacionit të nevojshëm në shkolla bëhet më datën *22 qershor* nga ora 12.00 deri në orën 19.00 dhe më *23 qershor* nga ora 07.00 deri në orën 19.00, sipas orarit të përgatitur nga shkolla. Renditja përfundimtare e secilës shkollë me rezultatet e regjistrimit dhe vendet e lira do të publikohen më *24 qershor 2023*, më së voni deri në ora 12:00 në tabelën e shpalljeve të shkollës dhe në www.mon.gov.mk.

Testi kualifikues do të organizohet në shkollat për arsim të mesëm më *26 qershor 2023*, ndërsa renditja përfundimtare me rezultatet do të publikohet më *26 qershor 2023* në tabelën e shpalljeve të shkollës dhe në www.mon.gov.mk.

Paraqitja e dytë e nxënësve do të bëhet më datë *27 qershor* deri në orën 24.00 dhe më *28 qershor 2023* deri në orën 15:00. Lista preliminare e nxënësve të regjistruar publikohet më

29 qershor 2023 në <https://e-uslugi.mon.gov.mk> dhe në ueb faqen www.mon.gov.mk më së voni deri ora 09:00. Dorëzimi i dokumentacionit të kërkuar në shkolla bëhet në datën 29 qershor nga ora 12.00 deri në orën 19.00 dhe në datën 30 qershor nga ora 07.00 deri në orën 19.00, sipas orarit të përgatitur nga shkolla. Ranglista përfundimtare e secilës shkollë me rezultatet e regjistrimit dhe vendet e lira do të publikohet më 1 korrik 2023, më së voni deri në ora 12:00 në tabelën e shpalljeve të shkollës dhe në www.mon.gov.mk.

Testi kualifikues do të organizohet në shkollat për arsim të mesëm më 3 korrik 2023, ndërsa renditja përfundimtare me rezultatet do të publikohen më 3 korrik 2023, në tabelën e shpalljeve të shkollave dhe në www.mon.gov.mk.

Nxënësit të cilët dërgohen në riprovime, provime të vitit, provim për avancim më të shpejtë mund të regjistrohen në shkollat ku do të mbeten vende të lira pas afatit të qershorit.

Paraqitja e nxënësve do të bëhet më 21 gusht *deri në orën 24:00*.

Lista preliminare e nxënësve të regjistruar do të publikohet më 22 gusht 2023 në <https://e-uslugi.mon.gov.mk> dhe në ueb faqen www.mon.gov.mk më së voni deri në ora 09:00. Dorëzimi i dokumentacionit të nevojshëm në shkolla bëhet më datë 22 gusht nga ora 10.00-19.00, sipas orarit të përgatitur nga shkolla. Renditja e listës përfundimtare të secilës shkollë me rezultatet e regjistrimit do të publikohet më 23 gusht 2023, më së voni deri në ora 12:00 në tabelën e shpalljeve të shkollës dhe në www.mon.gov.mk.

Pas publikimit të rang listave përfundimtare me rezultatet e regjistrimit, nxënësit që nuk janë regjistruar në shkollë, janë të detyruar të tërheqin të gjithë dokumentacionin e dorëzuar në shkollë në afat prej 24 orëve, ndërsa shkollat janë të obliguara t'ua kthejnë të gjithë dokumentacionin nxënësve në afat prej 24 orëve.

Aplikimi për regjistrim në programin e maturës ndërkombëtare në Shkollën e Mesme të Qytetit të Shkupit Gjimnazi- „Josip Broz Tito” - Shkup do të bëhet prej më *3 deri më 12 maj 2023*.

V. UDHËZIME PËR REALIZIMIN E KONKURSIT

Shkollat e mesme publike janë të obliguara shpalljet interne ti publikojnë në vende publike në shkollë deri më 19 prill 2023, në bazë të numrit të përgjithshëm të nxënësve dhe paraleleve të përcaktuara me këtë Konkurs.

Pas paraqitjes së parë, shkollat mund të zvogëlojnë numrin e përcaktuar të pikëve minimale të dhëna në Konkurs deri në 10 pikë, përveç regjistrimit në arsimin e gjimnazit, drejtimi ekonomi – drejtësi dhe tregti si dhe drejtimin shëndetësi, ku zvogëlimi i numrit të përcaktuar të pikëve në minimum nuk lejohet.

Shkollat janë të detyruara me shpallje interne për paraqitjen e dytë, përkatësisht paraqitjen e tretë të tregojnë pikat minimale të përcaktuara me të cilat është e mundur që nxënësit të konkurojnë për regjistrim në plan dhe program të caktuar. Shpallja e pikave minimale duhet të bëhet më *26 qershor 2023* për konkurimin e dytë.

Për nxënësit që kanë përfunduar klasën e nëntë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe një, dy ose tre klasë (VI, VII ose VIII) kanë përfunduar jashtë vendit, për ato klasë merret parasysh suksesi i klasës së nëntë dhe vlejnjë të njëjtat kritere për përzgjedhjen e nxënësve të dhënë më lartë.

Drejtori i shkollës së mesme formon komision shkollor për regjistrimin e nxënësve, i cili përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, si vijon:

- drejtori i shkollës;
- 4 (katër) anëtarë nga radhët e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë në shkollë.

Kryetari i komisionit është drejtori i shkollës, dhe komisioni mund të ketë zëvendës kryetar dhe zëvendës anëtarë.

Komisioni i shkollës përgjigjet për zbatimin në kohë dhe të rregullt të konkursit për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme brenda afateve të regjistrimit, përcakton shkallën e nxënësve të pranuar dhe vendos për ankesat nga nxënësit në listën e rangimit brenda 12 orëve pas theksimit të së njëjtës dhe i realizon kompetencat në vijim:

- formon komisione të veçanta (komision për pranimin e dokumenteve, komision për rangim dhe komision për testim kualifikuese në shkolla në të cilat do të paraqiten një numër më i madh i nxënësve të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara nga numri i përcaktuar në konkurs);

- publikon shpallje interne në përputhje me konkursin për çdo aplikim dhe e i publikon në vendin publik në shkollë;

- publikon rang listën e nxënësve të regjistruar;

- dorëzon raport për nxënësit e paraqitur dhe të regjistruar deri në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe komunë, përkatësisht Qytetin e Shkupit;

- ua kthen dokumentet e pranuar (përveç fletëparaqitjes) të nxënësve të cilët nuk janë regjistruar në shkollë pas çdo paraqitjeje në afat prej 24 orëve pas publikimit të rang listës përfundimtare;

- i vërteton rezultatet e testimit kualifikues të organizuar;

Komisioni për pranimin e dokumenteve kryen kompetencat në vazhdim:

- organizon pranimin dhe bën pranimin e dokumenteve;

- e kontrollon kompletimin e dokumenteve sipas ranglistave dhe përgjigjet për dokumentet e pranuar;

- arkivon dokumentet e pranuar dhe lëshon vërtetim për dokumentet e pranuar;

- jep informacione dhe udhëzime të nevojshme për nxënësit dhe prindërit për regjistrimin e nxënësve.

Komisioni për rangim i kryen kompetencat në vijim:

- bënë kontrollimin e dokumenteve të dorëzuara të përcaktuara në Konkurs dhe e dorëzon rang listën përfundimtare deri te komisioni i shkollës,

- Kundërshtesat e parashtruara nga nxënësit/prindërit i dorëzon deri te komisioni i shkollës,

- njofton komisionin e shkollës nëse janë paraqitur më shumë nxënës se numri i përcaktuar në Konkurs.

Në shkollat ku paraqiten numër më i madh i nxënësve sesa numri i paraparë në konkurs, ndërsa i plotësojnë kushtet e parapara, organizohet testim kualifikues. Testimi i referohet të gjithë nxënësve të cilët kanë numër të njëjtë të pikëve dhe janë nën dhe mbi numrin rendor të fundit të parashikuar për pranim në pajtim me konkursin.

Për realizimin e testimit kualifikues në shkollë ku janë paraqitur numër më i madh i nxënësve të cilët i plotësojnë kushtet e parapara nga numri i planifikuar të parashikuar në këtë konkurs, ministri me aktvendim formon komision të përbërë nga 5 anëtarë edhe atë:

- 2 përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës,
- 2 përfaqësues nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit dhe

- 1 përfaqësues nga shkolla në të cilën realizohet testimi kualifikues.

Kryetari i komisionit është përfaqësuesi i ministrisë, ndërsa komisioni ka zëvendëskryetar dhe zëvendësanëtar.

Testimi kualifikues i nxënësve do të realizohet në shkollën e mesme ndërsa në bazë të programit për provime dhe teste të përgatitura nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit.

VI. MBIKËQYRJA E IMPLEMENTIMIT TË KONKURSIONIT

Mbikëqyrja e implementimit të këtij Konkursi bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe Inspektorët e Autorizuar të Arsimit të komunave, përkatësisht Inspektorë të autorizuar të Arsimit të Qytetit të Shkupit.

**Ministër i Arsimit dhe Shkencës,
Doc. Dr. Jeton Shaqiri**